

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË PREFEKTURËN BERAT**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Prefekturën Berat, me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik dhe financiar, mbikëqyrjen e veprimtarisë së auditit të brendshëm, prokurimet me fonde publike, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 178, datë 30.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 1175/7, datë 30.12.2012, dërguar z. **Bujar Hoxha**, Prefekt i Beratit, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga ana e administratës të Institucionit të Prefektit, të çohen deri në fund zbatimi i 5 (pesë) rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm, në zbatim me kërkesat e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet në ligjin 8599, datë 01.6.2000, me Urdhrin nr. 70, datë 18.4.2006 të Kryeministrit “Për masat në respektimin e rekomandimeve të KLSH, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave dhe në institucionet vartëse të KM”.

**Brenda 31.03.2013**

2. Nga ana e zyrës financës të merren masa organizative dhe të hartohet program pune, të miratuar nga Prefekti Qarkut Berat, për të ulur në maksimum:

a- debitorët e krijuar në vitet e mëparshme gjatë vitit 2011 dhe 2012 e cila paraqitet me rritje në vlerën 394,861 lekë (Të bashkëpunohet me Gjendjen Civile dhe Drejtorinë e Tatimeve të Rrethit Berat për gjetjen e adresave të personave).

b-Të merren masa organizative për të ulur në maksimum furnitorët e krijuar para vitit 2010 dhe gjatë vitit 2011 dhe 2012 e cila paraqitet me rritje

-Për vitin 2010 rezultojnë 15 furnitorë në vlerën 799,475 lekë

-Për vitin 2011 rezultojnë 17 furnitorë për vlerën 986,101 lekë, prej të cilëve 15 prej tyre kanë origjinën nga vitet e kaluara.

**Në vazhdimësi**

3. Nga ana e Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, në të gjitha rastet për largimin nga detyra dhe marrja në punë e punonjësve të bëhet me procesverbal, konform kërkesave të Rregullores Brendshme “Për funksionimin e administratës së Prefektit Qarkut” (Sektori juridik dhe specialisti jurist, pika 10 dhe 14).

**Në vazhdimësi**

4. Nga ana e punonjësve të Sektorit juridik, për të gjitha rastet kur punonjësit janë në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit, duhet të marrë pjesë përfaqësuesi i Sektorit juridik, mbasi nga 19 punonjës të larguar nga detyra, 13 prej tyre kanë fituar gjyqin dhe në këto gjykime në 10 raste

punonjësit e Sektorit juridik nuk kanë marrë pjesë në gjykime në Gjykatën e Apelit Vlorë, veprim që përbën shkelje të nenit 460, paragrafi i dytë, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile” (Përbërja e gjykatës dhe gjykimi i çështjes) ku citohet: *Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve të bëhet nga Gjykata e Apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes, si dhe me Rregulloren e Brendshme “Për funksionimin e administratës së Prefektit të Qarkut”* (Sektorit juridik dhe specialisti jurist, pika 10 dhe 14).

**Në vazhdimësi**

**5.** Nga ana e Sektorit të PMNZSH- dhe Zyrës së Financës në Institucionin e Prefektit duhet të:  
a-Të kryhen kontratat e sigurimit, në shoqëritë e sigurimeve, të automjeteve, në inventar të Institucionit të Prefektit Berat, konform kërkesave me ligjin nr. 10070, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.  
b-Të gjitha automjetet e sektorit të PMNZSH-së ti nënshtrohen kontrollin teknik të detyrueshëm me qëllim, që të kontrollohen nëse ato garantojnë sigurinë dhe qetësinë në qarkullim dhe, që ndotja e tyre nuk i kalon kufijtë e përcaktuar, veprimi i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor”, i ndryshuar.

**Brenda 31.03.2013**

**6.** Nga specialistët e Sektorit të PMNZSH-së dhe Zyrës së Financës në Institucionin e Prefektit të ndërtohet program pune për realizimin e të ardhurave nga tarifatat dhe gjobat e vendosura nga specialistët e PMNZSH, kryesisht nga Prokuroria e Rrethit Berat, e cila në asnjë rast nuk ka xhiruar për llogari të prefekturës vlerën 2,225 mijë lekë.  
-Për vitin 2010 të pa arkëtuara 471,000 lekë, prej të cilave tarifa për akt ekspertiza në vlerën 425 mijë lekë dhe gjoba 46 mijë lekë.  
-Për vitin 2011 të pa arkëtuara 1,064,000 lekë, prej të cilave tarifa për akt ekspertiza në vlerën 1,050 mijë lekë dhe gjoba 14 mijë lekë.  
-Për 9 muhorin 2012, të pa arkëtuara në vlerën 772,000 lekë, prej të cilave tarifa për akt ekspertiza në vlerën 750 mijë lekë dhe gjoba 22 mijë lekë, sipas VKM nr. 285, datë 27.06.2002 “Për tarifatat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas dhe të huaj”.

**Gjatë vitit 2013**

**7.** Nga punonjësja e Zyrës së Financës në Institucionin e Prefektit të bashkëpunohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat për korigjimin e llogaritjes gabim të pagesës së qytetarit Agim Qeseja, me detyrë ish punonjës në PMNZSH, i larguar nga puna, i cili është paguar për më tepër në vlerën 78,800 lekë (4 pesëmbëdhjetë ditësh ose dy muaj) si rezultat i llogaritjes gabim nga gjykata dhe përmbarimit gjyqësor të dëmshpërblimit. (Paga mujore ka qenë 39,400 lekë).

**Brenda 31.03.2013**

## **B. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8927, datë 25.7.2012 “Për Prefektin”, i ndryshuar, si dhe në nenin nr. 13, germa “b” të Kontratës individuale të punës propozojmë marrjen e masës disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim**” për znj. [REDAKTUAR] me detyrë juriste në Sektorin Juridik për shkeljet e mëposhtme:

-nga 19 punonjës të larguar nga detyra, 13 prej tyre kanë fituar gjyqin dhe në këto gjykime në 10 raste nuk ka marrë pjesë në gjykime në Gjykatën e Apelit Vlorë, veprim në kundërshtim të pikës pika 10 dhe 14 të Rregullores të Brendshme të Institucioni të Prefektit “Për funksionimin e administratës së Prefektit të Qarkut” (Sektori juridik dhe specialisti jurist).

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Genci Koka, Sotir Kosdine dhe Qemal Meta. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Albert Thoma, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**